



VENDIM

Nr. 32, Datë 20.02.2017

MBI

FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDORË QË SHËRBEHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR PERIU DHËN 1 PRILL 2017 – 31 DHJETOR 2017.

Në mbështetje të nenit 16, 19, 47 dhe 83 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 6 pika 2 dhe 10 të VKM 244 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, nenit 19 gërma c të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e datës 20.02.2017, mbasi shqyrtoi relacionin “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, për periudhën 1 Prill 2017 – 31 Dhjetor 2017, të përgatitur nga Drejtoritë teknike,

Konstatohet se :

- ERE, me Vendimet Nr.191 datë 22.12.2016 dhe Nr. 192 datë 22.12.2016, ka filluar procedurat për shqyrtimin e aplikimeve për tarifa të reja të shërbimit të transmetimit dhe ato të shpërndarjes për çdo nivel tensioni për vitin 2017, bazuar në aplikimet e Shoqërive OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. respektivisht me shkresat Nr.7260/1 datë 30.11.2016 dhe Nr.29445 Prot., datë 09.12.2016
- Shoqëria OSHEE sh.a. në aplikimin e saj për tarifë për vitin 2017 ka kërkuar mos ndryshim të çmimeve për klientët fundorë por rialokim të kostove për nivele tensioni.
- OSHEE sh.a. ka paraqitur në ERE disa vlerësime/llogaritje lidhur me të ardhurat e kërkuara për aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë për vitin 2017 si argumente për mos ndryshimin e çmimeve të shitjes me pakicë të klientët tariforë.

- Në shkresën nr.682 Prot., datë 31.01.2017 MEI shprehet se “për të përmbyllur me sukses procesin e reformimit të Sektorit Elektroenergjitik është e nevojshme kryerja nga ana e ERE-s e një analize të drejtë të të ardhurave të kërkuara dhe kostove reale të operimit për secilën prej shoqërive publike, KESH, OST dhe OSHEE, me qëllim miratimin e tarifave përkatëse për vitin 2017 të cilat duhet të jenë transparente dhe të sigurojnë zhvillimin normal të aktivitetit në përputhje me kriteret që përcakton ligji dhe objektivat për qëndrueshmërinë e sistemit dhe stabilitetin financiar të sektorit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientet fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për periudhën 1 Prill 2017 – 31 Dhjetor 2017
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.